

Njoftim

Sot, më datë **24.05.2023**, ora **15:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Emona Muçi (Relatore);**
- 2. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 3. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 4. Marsela Dervishi (Anëtare);**
- 5. Sokol Ibi (Anëtar);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.24 Regj.Themeltar, Datë 22.05.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Safet Gjici.

Të paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve.

Person i interesuar: Qendra “Qëndresa Qytetare”, përfaqësuar nga z. Dhimitër Zguro.

Objekti: Shfuqizimi i Vendimit nr.85, datë 08.05.2023 të KAS për pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr.19 dhe nr.20, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Baza ligjore: Ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Ligji nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile” (i ndryshuar) nenet 31, 32, 154, ligji nr. 44/2015, të miratuar më datë 30.04.2015 “Kodi i Proc. Administrative në RSH”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, për shkak të mosparaqitjes së pajustificuar të paditësit në seancë gjyqësore, me Vendimin Nr.24, datë 24.05.2023, me shumicë votash,

VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit të çështjes nr.24 Regj. Themeltar, datë 22.05.2023.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 24.05.2023.

Tiranë, më 24.05.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë